



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtri

Bazuar në nenin 12 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 41.2 "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 24.11.2011, mori këtë:

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES PËR FILLIMIN DHE MBARIMIN E ORARIT TË PUNËS SË BIZNESEVE NË KOMUNËN E VUSHTRRISË

Neni 1

Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet neni 7.2 i Rregullores për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës së Bizneseve në Komunën e Vushtrrisë Nr.272/10, dt.30.12.2010, teksti i të cilit riformulohet si vijon:

"Ditëve të vikendit (të dielave) depot nuk punojnë, përveç depove të materialit ndëtimor".

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim, Drejtoria për Inspektion dhe Policia e Kosovës.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idrizi



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtri

Bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr:03/L-040;nenit 7 tw Ligjit pwr Festa Zyrtare tw R.Kosovës, nenit 7.4 dhe 41.2.”ç” të Statutit të Komunës së Vushtrrisë,Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 24.11.2011, mori këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E DITËS FESTIVE “DITA E PATATES” PËR KOMUNËN E VUSHTRRIË

Neni 1

Me këtë vendim përcaktohet ditë festive “Dita e Patates” në Komunën e Vushtrrisë,në mes të periudhës kohore nga dita 1 deri 10 e muajit tetor e çdo viti kalendarik.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim, Drejtoria për Inspektime, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Policia e Kosovës.

Neni 3

Organizimi “Dita e Patates” do të mbahet nën patronatin e kryetarit të komunës.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idrizi



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 24.11.2011, pas shqyrtimit të Propozim-vendimit për organogramin e Komunës së Vushtrrisë dhe duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/09 për transparencë nëpër komuna, mori këtë:

V E N D I M

Neni 1

Ipet në diskutim publik Propozim-vendimi për organogramin e Komunës së Vushtrrisë.

Neni 2

Diskutimi publik fillon nga data 25.11.2011 dhe zgjatë deri më 20.12.2011.

Neni 3

Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmerri masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna.

Neni 4

Obligohet Drejtoria për Administratë që si hartues dhe propozues i Draft-rregullores në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 2008/09.

Gjithashtu DA-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të propozim-vendimit në fund të muajit Dhjetor 2011.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idriz